3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

**23. Njoftimi i Fituesit** 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin

[Type text]

---

Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi  
i Marrëveshjes  
Kuangër/  
Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuangër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

**25. Procedura e  
ankesës**

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

**26. Anulimi i  
procedurës**

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....	
Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve .....	
Shtojca3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....	
Shtojca5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	
Shtojca6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit.....	
Shtojca 7. Termat e referencës	
Shtojca8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....	
Shtojca9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	
Shtojca10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....	
Shtojca11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit .....	
Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)	
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)	

---

## Shtojca1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimetpër **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve tëShërbimevedhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve tëShërbimeve.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

[Type text]

---

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



**Shtojca2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	Afati
1.	Furnizime dhe shërbime me ushqim për mensat për vitin 2022-2023	100 racione për 256 ditë nga e hëna në të premte dhe 50 racione për 51 ditë të shtuna. Racione total 28 150.			307 ditë
2.					
3.					

[Type text]

4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

**Shënim:** Vlera për një racion ditor pa TVSH është 191.666 (njëqind e nëntëdhjetë e një pikë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë.

Racione Total për 307 ditë=(256/ditë x 100 racione x 191.666) + (51 ditë të shtune x 50 racione x 191.666) = 5 395 397.9 Leke pa tvsh dhe 28 150 racione total.

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

[Type text]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

**Shtojca 5.****FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Mbështetur në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.94 datë 26.08.2019, “Për miratimin e nivelit të kuotave financiare për shpenzime ditore të ushqimeve për personat që përfitojnë shërbime në qendrat sociale të përkujdesit shoqëror në varësi të Bashkisë” pika 1.Të miratojë nivelin e kuotës financiare për shpenzime ditore të ushqimeve për personat që përfitojnë shërbime në qendrat sociale të përkujdesit shoqëror në varësi të Bashkisë Tiranë në vlerën 230 (dyqind e tridhjetë)lekë me tvsh.

**SPECIFIKIMET TEKNIKE****GRAMATURAT**

<b>1.FASULE ME MISH</b>		<b>2.PILAF</b>		<b>3.SUPE ME ORIZ</b>	
FASULE	100gr	ORIZ	100gr	Leng mishi	
Mish	50gr	Gjalpe	10gr	oriz	100gr
Qepe	10gr	kripe	5gr	Domate	30gr
leng mishi		leng mishi		kripe	5gr
salce	5gr			piper	3 gr
Kripe	5gr			majdanoz	5gr
Piper	3gr			Koper	5 gr

<b>4.PASTICE</b>		<b>5.TURLI ME ZARZAVATE &amp;MISH</b>			
Spageti	100gr	perime te ndryshme (spec;		80 gr per	
veze	1koker	patellxh, kunguj, karrot, patate)		Secilen	
qumesht	70gr	salce k	20	kripe	5gr
djath bar	50gr	qepe	20 gr	Piper	3gr
gjalpe	30gr				
miell	20 gr				

[Type text]

kripe	5gr	Vaj	20gr		
-------	-----	-----	------	--	--

6.Gjelle me patate me mish			7.Gjelle me laker &mish		
mish	80 gr		mish	80 gr	vaj 20gr
patate	80 gr		laker	80 gr	kripe 5gr
qepe	20gr		salc dom	10 gr	piper 3 gr
salce dom	10 gr		leng mishi		
leng mishi			uthull	10gr	
kripe	5gr		hudhra	5gr	
piper	3 gr		qepe	20gr	

8.MISH me qepe	
mish	50 gr
qepe	50gr
miell	20 gr
kripe	5gr
salce	5gr
leng mishi	
Hudhra	25gr
miell	10gr

9.Gjelle bizele karrota patate mish			10.Supe me perime	
qepe	10gr			
bizele	20gr	kripe 5gr	perime te ndyshme	130 gr
karota	20gr	piper 3gr		
patate	20		domate te	70 gr

	gr		fresketa	
mish	70		Piper	3gr
salce	10gr		Kripe	5gr
leng mishi				

11.MAKARONA		12.QULL ME KOFSHA PULA	
spageti ose fusili	100gr	MISH PULE	120gr
gjalpe	30gr	Miell	10 gr
leng mishi		Gjalp	20gr
kripe	5 gr	salc	
		dom,	10 gr
		leng mishi(pule)	
		Hudhra	5 gr
		Uthull	10 gr

13.MAKARONA ME KIME			
Spageti ose fusli	100gr	BUKE	250 gr
mish I grire	70gr	FRUTA	100 gr
Qepe	20gr	EMBELSIRE	100 gr
leng mishi			
salc dom	10gr		
karota	10gr		
ver,bardh	10gr		

14.BURANI ME SPINAQ DHE MISH	

[Type text]

Oris	100gr
Mish	50 gr
Spinaq	30gr
kripe	5gr
Piper	3gr
Majdanoz	5gr
Koper	5gr

<b>15. SALLATE ME LAKER TE GRIRE</b>	
LAKER	100gr
KARROTA	5gr
vaj ulliri	5ml
Kripe	5gr

<b>16.Sallate jeshile</b>	
Sallate jeshile	50gr
djath te bardhe	10 gr
vaj ulliri	5ml
Kripe	5gr
Kastravec	20gr

<b>17.Sallate me domate</b>	
domate	100gr
Qepe	10 GR
vaj ulliri	5ml
Kripe	5gr



---

1. Ushqimi ditor do të përmbajë :

- Pjatë e parë 200 gr
- Pjatë e dyte 200 gr
- Bukë 250 gr
- Fruta / Kek 100 gr
- Kos 200gr
- Sallate 20 gr
- Caj 3.5 gr

**Operatori ekonomik duhet të ketë inventarin e nevojshëm për ruajtjen, përpunimin, gatimin, dhe shpërndarjen e ushqimit, për një grup personash prej 100 veta per vaktin e drekes, sipas orareve të përcaktuara.**

1. Banjomarina
2. Tabaka -- 100 cope
3. Luge –100 cope
4. Piru – 100 cope
5. Tas per supen –100 cope
6. Pjata gjelle –100 cope
7. Pjata te vogla -100 cope
8. Gota uji – 100 cope
9. Mushama
10. Letra
11. Ndareset e ushqimit (garuzhde etj)

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

[Type text]

- 
2. Vlera për person do të jetë 191,666 (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë pikë gjashtëqind gjashtëdhjetë e gjashtë) leke pa tvsh
  3. Numri maksimal i racioneve të porositura do të jetë jo më shumë së 100 racione ditë e javës dhe 50 racione ditë e shtunë.
  4. Qendra Komunitare do të njoftojë në orën 09: 30 për numrin e saktë të racioneve që do të porositen.
  5. Qendra Komunitare do të furnizohet me Ushqim të Gatshëm nga e hena në të shtunë në orën 12:00 pranë ambjenteve të qendrës.
  6. Qendra do të pajiset çdo ditë me një faturë provizore ku do të cilësohen numri i menuve të mara në dorëzim, cmimi si dhe vlera në lekë e ushqimit të sjellë

### **Kërkesa të Përgjithshme**

1. Operatori ekonomik është i detyruar të zbatojë procedurat e menaxhimit të ushqimit të kërkuara në urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.
2. Operatori ekonomik duhet të ketë inventarin e nevojshëm për ruajtjen, përpunimin, gatimin, dhe shpërndarjen e ushqimit, për një grup personash prej 100 veta për vaktin e drekës, sipas orareve të përcaktuara.
3. Operatori ekonomik të sigurojë e disponojë në guzhinë, mjete matëse të sasisë të certifikuar nga inspektorati i kalibrimit të njësisë matëse.
4. Çdo ditë përfaqësues të operatorit ekonomik do të rakordojnë me personin e ngarkuar nga titullari i Qendrës Komunitare "Të Qëndrojmë së Bashku" për hartimin e forcës ditore të ushqimit dhe për konsumin e tij, në Qendrën komunitare..
5. Operatori ekonomik, nuk mund të transferojë, kalojë pa pëlqimin e autoritetit kontraktor, detyrimet e tij, kontraktuale një pale të trete.
6. Operatori ekonomik do të paraqesë në fund të çdo muaji faturën dhe dokumentacionin justifikues për sasinë e mallrave të furnizuar.

### **Kërkesa teknike për përgatitjen e ushqimit dhe sigurinë ushqimore.**

#### **Siguria ushqimore**

1. Te gjithë artikujt ushqimore që do të përdoren për gatim do të jenë të freskëta, sipas specifikimeve teknike për lëndet e para të përcaktuara në këtë dokument.

- 
2. Ushqimi te jete i gatuar ne çast, racioni ditore duhet te përmbajë sasi të e duhura te artikujve sipas liste menuse javore dhe ditore, ushqimi te shpërndahet i ngrohte sipas orareve te përcaktuara nga Administrata e Qendres Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku”.
  3. Ne asnje rast nuk do te lejohet zëvendësimi i artikujve ushqimore, qe jane përcaktuar ne normen baze te ushqimit, me përjashtim te rasteve te fatkeqesive natyrore apo te fuqise madhore.
  4. Personeli qe do te realizoje procesin e prodhimit te ushqimit, te kete kualifikimin e nevojshem profesional.

### **MENAXHIMI I SHËRBIMIT NGA AUTORITETI KONTRAKTOR**

1. Te verifikojë për vaktin e drekes numrin e personave qe trajtohen me ushqim (forca ditore) te detajuar:
  - Numri i personave qe trajtohen me nje vakt.
2. Autoriteti Kontraktor te kontrolloje e ti kërktojë operatorit ekonomik respektimin e orarit te gatimit dhe shpërndarjes se ushqimit, zbatimin e normave te racioneve te ushqimit, si dhe pastërtinë ne ambientet e gatimit te ushqimit dhe te shpërndarjes se ushqimit.
3. Autoriteti Kontraktor, te mos lejojë operatorin ekonomik qe te përdorë pajisje për gatim dhe inventarë te imët për shpërndarjen e ushqimit jashtë specifikimeve te kërkua ne këtë shkresë dhe dokumentet standarde te tenderit.
4. Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet komisionit te ngritur me urdhër te titullarit, do te regjistroje veprimet ekonomike për sasinë e racioneve ditore te prodhuar ne dite te detajuara ne numër rendore me një vakt, veprimet për likuidimin e detyrimeve te lindura ndaj operatorit ekonomik do te rregullohen me urdhër te veçantë te titullarit te Autoritetit Kontraktor.
5. Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menuse javore të ushqimit të miratuar, konform normës bazë të ushqimit.
6. Menuja e ushqimit do të sigurojë sasinë, cilësinë sipas normës bazë të ushqimit.
7. Te disponojë mjete transporti te përshtatshme për transport te produkteve ushqimore te fresketa si dhe ato te gatuar, te cilat te plotësojnë te gjitha kushtet higjieno-sanitare sipas standardeve ne fuqi.

[Type text]

---

## **Programi Ushqimor**

1.Sipërmarrësi do te zbatoje planin e menuse ditore dhe javore te ushqimit sipas programit te miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.Programi ushqimor do te siguroje sasinë, cilësinë e duhur te ushqimit. Sasia dhe cilësia e ushqimeve qe furnizohen nga sipërmarrësi duhet tu përgjigjen kushteve qe përcakton Ligji mbi ushqimin

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent

---

## Shtojca 6

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen:

### SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

#### MENU DIMËRORE

#### Java e I-re dhe e III-te

	<b>E HENE</b>	<b>E MARTE</b>	<b>E MERKURE</b>	<b>E ENJTE</b>	<b>E PREMTE</b>	<b>E SHTUNE</b>
<b>1</b>	Fasule me mish	Supë me oriz	Gjellë me lakër	Turli me zarzavate	Gjellë me presh	Supë me perime
<b>2</b>	Pilaf	Makarona me qofte	Byrek me gjizë	Makarona me salce	Pilaf	Byrek me qepë
<b>3</b>	Buka	Buke	Buke	Buke	Buke	Buke
<b>4</b>	embelsire	Fruta	embelsire	Fruta	Embelsire	Fruta
<b>5</b>	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos
<b>6</b>	Turshi	Sallat fshati	Sallat jeshile	Sallat lakër të grirë	Sallat jeshile	Sallat fshati
<b>7</b>	Caj	Caj	Caj	Caj	Caj	Caj

#### 2. JAVA E II-te DHE IV-et

[Type text]

NR	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNE
1	Gjelle me laker	Gjelle, patate, mish	Burani me spinaq	Gjelle me bizele, karrota, patate	Mish me qepë	Supe me perime
2	Pilaf	Byrek me gjizë	Pastice	Pispili	Byrek	Makarona
3	Buke	Buke	Buke	Buke	Buke	Buke
4	embelsire	fruta	embelsire	Fruta	embelsire	Fruta
5	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos
6	Sallat Domate	Turshi	Sallat jeshile	Sallat me lakër te grirë	Sallat Domate	Sallat jeshile
7	Caj	Caj	Caj	Caj	Caj	Caj

### MENU VERORE

#### Java e I-re dhe e III-te

	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNE
1	Specat të mbushur	Supe Pule	Gjellë me bamje me mish	Barbunja me mish	Patëllxhanë të mbushur	Fërgesë
2	Tarator	Patate Furre	Pilaf	Makarona	Tarator	Makarona
3	Buka	Buke	Buke	Buke	Buke	Buke
4	Ëmblësirë	Fruta	Embelsire	Fruta	Embelsire	Fruta

5	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos
6	Sallatë jeshile	Sallat fshati	Sallat jeshile	Sallat lakër të grirë	Sallat jeshile	Sallat fshati
7	Caj	Caj	Caj	Caj	Caj	Caj

## **2. JAVA E II-te DHE IV-er**

NR	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNE
1	Supë me perime	Gjelle Verore	Gjellë me bamje me mish	Turli me zarzavate	Fërgesë	Pispili
2	Kunguj me kos	Byrek me gjizë	Pilaf	Makarona me salcë	Byrek me qepë me domate	Speca të mbushur
3	Buke	Buke	Buke	Buke	Buke	Buke
4	Embelsir e	Fruta	Embelsire	Fruta	Embelsire	Fruta
5	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos	Kos
6	Sallat Domate	Sallatë jeshile	Sallate fshati	Sallatë jeshile	Sallat Domate	Sallat jeshile
7	Caj	Caj	Caj	Caj	Caj	Caj

**AFATET E EKZEKUTIMIT: Nga momenti i nënshkrimit së kontratës, për 12 (dymbëdhjetë) muaj.**

[Type text]

---

**Vendi i kryerjes së shërbimeve: Qendra Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku”,  
Bashkia Tiranë.**

**Shtojca 7**

*( Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

## **TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Ofrimi i një vakti të ngrohtë ushqimor për kategorinë e njerzëve në nevojë nga e hëna në të shtune.

Detyrat:

Te gjithë artikujt ushqimore qe do te përdoren për gatim do te jene te cilësisë se pare, te freskëta, sipas specifikimeve teknike për lëndet e para te përcaktuara ne këtë dokument.

Ushqimi te jete i gatuar ne çast, racioni ditor duhet te përmbajë sasi të e duhura te artikujve sipas liste menuse javore dhe ditore, ushqimi te shpërndahe i ngrohte sipas orareve te përcaktuara nga Administrata e Qendres Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku”.

Ne asnje rast nuk do te lejohet zevendesimi i artikujve ushqimore, qe jane percaktuar ne normen baze te ushqimit, me perjashtim te rasteve te fatkeqesive natyrore apo te fuqise madhore.

Personeli qe do te realizoje procesin e prodhimit te ushqimit, te kete kualifikimin e nevojshem profesional, si dhe te jete pajisur me libreze shendetesore.

Shpërndarja: Ushqimi duhet të vijë nga e hëna në të shtune në Ambjentet e Qendrës Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku”.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Qendra Komunitare “Të Qëndrojmë së Bashku”, Bashkia Tiranë.

Rruga “Sabaudin Gabrani” ish Uzina e Drurit Misto Mame, Tiranë.



---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

[Type text]

---

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektivit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

---

2.Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2018, 2019, 2020) që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet.

3.Vërtetim të lëshuar nga Bashkia ose Drejtoritë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 pranë të gjitha njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

- Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB

***Shënim:*** Për vërtetimin e shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartpërmendur.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1**Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Licence Profesionale për ushtrimin e aktivitetit me objekt perpunim dhe shperndarje e ushqimit e vlefshme, lëshuar nga QKB, II.1.A(1).

**2.3.2**Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.3.3.**Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

1) Çertifikatë e menaxhimit për sigurinë ushqimore sipas konformitetit me standartet evropiane (**HACCP**). (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën (**HACCP**)).

[Type text]

2) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

a). Certifikate të cilësive të shërbimit ISO9001:2015 ose të përditësuar;

b). Certifikate; ISO 22000:2018 certifikatë e sistemit të Menaxhimit të sigurisë Ushqimore ose ekuivalente me të.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën/certifikatat ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.*

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar (Deklarate nga Administratori i shoqërisë) në stafin e tij **7 persona** pjesë të tyre profesionist si: 2 Kuzhinier (kontrata e punës, dëshmi kualifikimi), 2 ndihmës /kuzhinier(kontraten e punës), 1 merceolog (diploma plus kontrata e punës), 2 punonjës shërbimi/shofer (kontrate pune dhe lejen e drejtimit) të nevojshëm për realizimin e shërbimit të ushqimit

- Staf i mësipërm duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre)muajt e fundit, (nëntor,dhjetor,janar).

Nr	Personeli	Sasia
1	<b>Kuzhinier</b>	2
2	<b>Merceolog</b>	1
3	<b>Ndihmes Kuzhinier</b>	2
4	<b>Punonjës shërbimi/shofer</b>	2
<b>Total</b>		<b>7</b>

*Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartpërmendur.*

2.3.5 Deklarate nga Operatori ekonomik se disponon në pronësi ose me qera një mjet transporti që kryen transportin e produkteve ushqimore e frigoriferikë për të gjithë periudhën e realizimit të shërbimit objekt prokurimi.

- Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi (vertetuar me aktin e pronësisë kopje e noterizuar), ose në përdorim/me qera vertetuar me kontratat përkatëse për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës 1 (një) mjet transporti ATV të shoqëruar me: Leje qarkullimi, Çertifikate të kontrollit teknik(e vlefshme), Sigurim të mjetit(e vlefshme), Certifikate pronësie e mjetit.

---

**Leje higjeno-sanitare** per automjetin, leshuar nga Drejtoria e Shendetit Publik e rrethit ku ushtron aktivitetin perkates,**e vlefshme** per periudhen e realizimit te objektit te kontrates.

**Shënim:** Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftim fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartpërmendur.

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet te disponoje te pakten 1 ambient ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit. Per te plotesuar kete pike operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Dokumentacionin qe verteton pronesine ose marrjen me qera te ketij ambienti per aktivitetin prodhim dhe shperndarje te ushqimit katering.
- Dokumentacionin qe verteton pronesine ose marrjen me qera te ketij ambienti per aktivitetin prodhim dhe shperndarje te ushqimit katering.
- Leje higjeno - sanitare per objektin ne fjale.

**2.3.7**Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.

- Për këtë duhet të paraqesi vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga Autoriteti në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.
- Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka për detyrim të paraqesi dokumentacion provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetin konform kërkesave ligjore.

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinali”.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

- 
- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.*
  - *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.*

***b. Operatori ekonomik fitues, para nënshkrimit kontratës duhet të dorëzojë:***

- *Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.*
- *Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Çertifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes softwerike.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 9.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

## FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

### Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

[Type text]

--	--	--	--

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm



<p>për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
